

VIZE PER BASHKIM FAMILJAR ME PERSONA ME VENDBANIM NE ITALI QE NUK JANE NENSHTETAS ITALIANE OSE TE BASHKIMIT EUROPIAN

Viza për Bashkim Familjar me persona me vendbanim ne Itali që nuk janë nënshtetas italianë ose të Bashkimit Europian, i lejon hyrjen në Itali atij personi i cili përmbush kushtet mbi ushtrimin e së drejtës për Bashkim Familjar të parashikuara nga dispozitat ligjore italiane në fuqi. Më saktësisht, këtë të drejtë e gëzojnë kategoritë e mëposhtme:

- bashkëshorti/tja i/e cili/a në momentin e Bashkimit Familjar të mos jetë ligjrisht i/e ndarë dhe të mos jetë nën moshën 18 vjeç;
- fëmijët, të ligjshëm apo natural, të adoptuar ose të bashkëshortit/es së mëparshëm/me, të cilët, në datën e kërkesës së Nulla Osta-s për Bashkim Familjar, të kenë qënë nën 18 vjeç;
- prindërit e personit me vendbanim në Itali të cilët të mos kenë fëmijë të tjerë në vendin e origjinës ose prindër, mbi 65 vjeç, fëmijët e së cilëve, për arsye të rënda shëndetësore, të mos jënë në gjendje t'i mbajnë ekonomikisht në vendin e origjinës;
- fëmijë në moshë madhore (mbi 18 vjeç) të cilët për shkak të invaliditetit të tyre total të mos jënë në gjendje të kryejnë edhe nevojat më themelore jetësore.

Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për Bashkim Familjar duhet të paraqitet personalisht pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me gërma të mëdha shtypi. Kërkesës për vizë duhet t'i bashkangjiten dokumentet e poshtëshënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:

- 1) Pasaportë të vlefshme** të paktën 16 muaj nga data e fillimit të afatit të vizës së kërkuar;
- 2) Nulla Osta** për Bashkim Familjar e lëshuar nga Autoritetet Italiane kompetente (**Sportello Unico per l'Immigrazione**) me datë jo më të hershme se 6 muaj;
- 3) Fotokopje e qartë e lejes së qëndrimit** (Permesso di Soggiorno/Carta di Soggiorno) të bashkëshortit/es (djalit/vajzës) me banim në Itali si edhe **kopje e qartë e kërkesës për vazhdimin e afatit**, nëse Lejes së Qëndrimit i ka dalë afati;
- 4) Dokumente të Gjendjes Civile** që vërtetojnë lidhjen familjare me personin me banim në

Itali:

-nëse bashkimi familjar bëhet me bashkëshortin/en me banim në Itali:

çertifikata e martesës, e lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

-nëse bashkimi familjar bëhet me babain/nënëen me banim në Itali:

çertifikata/t e lindjes e/së fëmijës/ve, e/të lëshuar/a nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e/të legalizuar/a nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

-nëse bashkimi familjar bëhet me djalin/vajzën me banim në Itali:

çertifikata e lindjes e djalit/vajzës me banim në Itali, të lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

5) Deklarata mbi Bashkësinë Familjare që dëshmon mbajtjen e anëtarëve të familjes, i lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj, dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

KUJDES: në këtë dokument duhet pasqyruar **gjendja familjare reale** e të interesuarit pavarësisht nga fakti nëse në të janë të pranishëm edhe familjarë të tjerë që nuk duhet të udhëtojnë për në Itali.

*****Në rast bashkimi familjar me babain/nënë** me vendbanim në Itali të **të miturve që udhëtojnë vetëm**, përveç dokumenteve të lartshënuar, do të kërkohet **Pëlqimi mbi daljen e përhershme të të miturit për Bashkim Familjar**. Pëlqimi jepet përpara zyrtarit përgjegjës për viza pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë nga prindi që mbetet në Kosovë dhe që nuk është i pajisur me vizë ose Leje qëndrimi të vlefshme në Itali ose pranë një noteri.

*****Në rast bashkimi familjar me djalin ose vajzën me vendbanim në Itali**, përveç dokumenteve të lartshënuar duhet të paraqiten edhe dokumentet e mëposhtëme: **Vërtetim mbi pensionet** (nëse aplikuesi është në pension)/ **Kontratë e punës** (nëse aplikuesi është në raport pune)/ **Vërtetim mbi papunësinë** (nëse aplikuesi nuk e ka mbushur moshën për pension dhe nuk është në marrëdhënie pune); **çertifikatë vendbanimi e djemve dhe vajzave në Kosovë**, e lëshuar nga komuna kompetente, **çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore, model CM0201**, ku të vërtetohet që janë të aftë për punë si edhe **kopjet e Lejeve të Qëndrimit** në shtete të tjera (nëse fëmijët jetojnë jashtë Kosovës).

AMBASADA ITALIANE PRISHTINE